

VENDIM
Nr.983, datë 30.9.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS TERPAN, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Terpan të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Terpan të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.926, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Terpan, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Terpan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Terpan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
14-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
16-25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
26-40	Varrezat publike	Në pronësi
41-60	Infrastrukturë (Rrugë vendore)	Në pronësi
61-74	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
100-133,135-137,140-142,144-146,148-151,153-163	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
134,138,139,143,147,152	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi